



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Prishtinë, 21 shtator 2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, me rastin e fillimit të fushatës zgjedhore të subjekteve politike për Zgjedhjet Komunale të 22 tetorit 2017, lëshon këtë:

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Duke llogaritur që institucionet e Republikës së Kosovës, subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet si dhe Organizatat e Shoqërisë civile janë mire të informuara me mandatin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa –PZAP-i, dëshirojmë të ritheksojmë që në bazë të nenit 115.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – LZP, PZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore.

Qëllimi i kësaj komunikate është që të rikujtojmë subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët për të kontribuar në krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Subjektet politike, mund të organizojnë çfarëdo tubimi ose fjalimi politik, mbledhje, prezantim publik, ose ndonjë aktivitet të përgatitur për të përçuar mesazh politik në lidhje me zgjedhjet. Por, subjektet politike janë të obliguara të respektojnë Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme - LZP-së dhe Rregullën nr. 13 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve-KQZ që rregullojnë Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimet për Ngjarjet Politike. Kjo kornizë ligjore vendos rregullat bazë për të drejtat për fushatë zgjedhore, por edhe atë se çka mund të përdoret si material i fushatës, vendet e lejuara dhe të ndaluara për fushatë, kohen dhe vendin ku duhet të dërgohet njoftimi për mbajtjen e tubimit politik.

Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me 22 tetorit 2017, KQZ ka vendosur që periudha e fushatës zgjedhore të zgjas tridhjetë (30) ditë. Pra, për bërjen e fushatës zgjedhore të subjekteve politike, kandidatëve të tyre, anëtarëve të subjekteve politike dhe mbështetësve të tyre afati u fillon me 21 shtator 2017 dhe përfundon një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve me 20 tetor 2017.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP-i, në bazë të nenit 120. Paragrafi c. te Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme - LZP-se për mosrespektim të legjislacionit në fuqi mund të vendos gjoba ndaj subjekteve politike në vlerë deri në 50,000.00 euro.

Duke konsideruar natyrën e ankesave të parashtruara nga subjektet politike dhe Organizatat e Shoqërisë Civile –OJQ për zgjedhjet e 11 qershorit 2017 si dhe vendosjen meritore të këtyre ankesave nga PZAP-i, mund të konstatojmë se subjektet politike shkeljet me të shpeshta gjatë këtij procesi zgjedhorë i kanë bërë gjatë fushatës zgjedhore duke vendosur postera në hapësirat publike.

Gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 qershor 2017, PZAP-i ka shqipëruar gjoba ndaj subjekteve politike për shkak se ato kanë shkelur Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve të LZP-së, në shumë prej: **348,900.00 euro**

Shumat e gjobave të caktuara ndaj subjekteve politike nga PZAP-i kanë qenë si në vijim:

| | |
|---------------------------------------|-----------------|
| Koalicioni - PDK,AAK,NISMA etj. | 158,000.00 euro |
| Koalicioni LDK-AKR-ALTERNATIVA etj. | 71,700.00 euro |
| LVV | 62,600.00 euro |
| G.I.SRPSKA LIST | 35,600.00 euro |
| Kosovo Demokratik Turk Partisi - KDTP | 8,400.00 euro |
| Samostalna Liberanlna Stranka - SLS | 3,800.00 euro |
| Progresivna Demokratska Stranka - PDS | 2,600.00 euro |
| Partia FJALA | 2,600.00 euro |
| Partia e Ashkalive për Integrim - PAI | 1,200.00 euro |
| Partia Demokratike e Unitetit – PDU | 1,200.00 euro |
| Koalicioni – VAKAT | 1,200.00 euro |

Gjithsejtë: 348,900.00 euro

Për fund, PZAP fton subjektet politike, kandidatët e tyre, anëtarët e subjekteve politike dhe mbështetësit e tyre, si dhe Organizatat e Shoqërisë Civile dhe median që të vazhdojnë bashkëpunimin e mirë me PZAP me qëllim të zbatimit të plotë të ligjit dhe krijimit të një atmosfere zgjedhore fer dhe demokratike.

Shtojcë 1.

Me qëllim të informimit të subjekteve politike, mbështetësve të tyre dhe kandidateve, respektivisht parandalimit për të mos renë ndesh me Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve të LZP-së, kësaj komunikate i shtojmë edhe Kreun V të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – LZP-së që ka të bëjë me Fushatën Zgjedhore.

KREU V

KODI I MIRËSJELLJES PËR SUBJEKTET POLITIKE, MBËSHTETËSIT E TYRE DHE KANDIDATËT

Neni 31

Qëllimi i Kodit të Sjelljes

Kodi i Sjelljes për subjektet politike dhe mbështetësit e tyre dhe kandidatët ka për qëllim krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Neni 32

Përgjegjësitë e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve

32.1 Këtij Kodi i detyrohen të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre.

32.2 PZAP-i ka autoritet ligjor të marrë vendim në pretendimet se janë shkelur dispozitat e këtij Kodi si dhe të shpallë sanksione dhe kompensime në përputhje me procedurat e saj.

32.3 Subjektet politike informojnë në mënyrë të duhur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre rreth dispozitave të këtij Kodi.

32.4 Subjektet politike ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre nga shkelja e këtij Kodi.

32.5 Subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre.

32.6 Subjekti politik mund të paraqesë prova pranë PZAP-i që tregojnë se ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar dhe/ose dekurajuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij nga shkelja e këtij Kodi. Këto dëshmi mund të përdoren në përcaktimin e duhur të masave të mëtejshme dhe mund të përfshijë dëshmi se:

a) Subjekti politik ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij për dispozitat e këtij Kodi dhe nevojat për të zbatuar dispozitat e tij;

- b) Subjekti politik dhe kandidatët e tij publikisht janë shprehur për dënimin e dhunës, kërcënimeve me dhunë, apo frikësim gjatë procesit zgjedhor;
- c) Subjekti politik në mënyrë publike dhe aktive ka bërë qortimin e anëtarëve, mbështetësve dhe kandidatëve të tij për çdo shkelje të ligjeve të aplikueshme që kanë të bëjnë me zgjedhjet;
- d) Subjekti politik nuk ka nxitur, shtytur apo përkrahur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij në shkeljen e Rregullave të Zgjedhjeve në ndonjë rast të veçantë apo në raste tjera; dhe
- e) Çdo provë tjetër në lidhje me përpjekjet e subjektit politik për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij nga shkelja e Rregullave të Zgjedhjeve.

32.7 Secili kandidat nënshkruan një deklaratë me të cilën konfirmohet se ai ose ajo do i bindet të gjitha ligjeve të aplikueshme dhe mbështet zbatimin e plotë të rezultateve zgjedhore të certifikuara.

Neni 33

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

- a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;
- b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;
- c) mbajtja ose ekspozimi i armëve të secilit lloj gjatë tubimeve politike ose gjatë çfarëdo lloj ngjarjeje që ka lidhje me aktivitetet e subjekteve politike. Mbajtja e armëve nga personat e tjerë gjatë tubimeve politike/manifestimeve lejohet vetëm në rast se personat që mbajnë armë të tilla janë të autorizuar për një gjë të tillë nga autoritetet përkatëse dhe që Policia e Kosovës është njoftuar paraprakisht se të tilla armë do të mbahen në tubimet e caktuara;
- d) çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë;
- e) pengimi ose tentimi për pengimin e gazetarëve për të përmbushur detyrat e tyre profesionale;
- f) premtimi i ndonjë shpërblimi financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve;
- (g) kërcënimimi ose tentimi për të kërcënuar subjektet tjera politike, përkrahësit ose kandidatët e tyre;
- h) nxitja e cilitdo person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote;
- j) nxitja e personit për të votuar më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje ose të votojë në emër të një personi tjetër;
- k) abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në PZAP;

l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë; ose

m) për qëllime të promovimit të subjektit politik ose kandidatëve të tij duke përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali i cili i referohet personit i cili:

(i) është në vuajtje të dënimit të shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish- Jugosllavinë; ose

(ii) ka padi të ngritur nga Tribunali dhe i cili nuk i është përmbajtur urdhrin për t'u paraqitur para Tribunalit.

Neni 34

Frikësimi dhe Dhuna Gjatë Procesit Zgjedhor

34.1 Përdorimi ose kërcënimet me përdorim të dhunës së çfarëdo lloji nga subjekti politik, anëtarët, mbështetësit ose kandidatët e tyre, ndalohet rreptësisht.

34.2 Asnjë subjekt politik ose kandidatët nuk inkurajojnë, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcënimet me dhunë ose kanosje, gjatë procesit zgjedhor. Secili subjekt politik i informon anëtarët dhe mbështetësit e tij për nevojën për të shmangur një sjellje të tillë.

34.3 Fushata zgjedhore organizohet në atë mënyrë që një atmosferë e pëlqyeshme dhe paqësore të mbizotërojë gjatë fushatës zgjedhore.

Neni 35

Veprimet e Ndaluar Nga Shërbyesit Publik

35.1 Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.

35.2 Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik.

Neni 36

Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit

36.1 Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;

b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Neni 38
Sanksionimi për Shkeljet e Parimeve të këtij Kodi

38.1 Shkelja e njërit nga këto nene të Kodit të Sjelljes të paraqitur në këtë Kapitull, në rastet kur këto shkelje nuk kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, konsiderohet shkelje administrative dhe e dënueshme me gjobë sikurse është përcaktuar nga PZAP-i.

38.2 Shuma e gjobës përcaktohet në bazë të nenit 46 të këtij ligji.

38.3 Shkeljet e Kodit të Sjelljes të përcaktuara nga PZAP-i të cilat kanë tentuar të ndikojnë rezultatet e zgjedhjeve paraqesin ve për penale sipas Kodit Penal të Kosovës.

Neni 46
Sanksionet

Përveç përgjegjësisë individuale për cenimin e cilësdo dispozitë të këtij Kapitulli, që është e ndëshkueshme me Kodin Penal të Kosovës, cenimet gjithashtu mund t'i referohen Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa mund t'i shqiptojë sanksione subjektivit politik që ka shkelur këtë dispozitë të këtij Kapitulli.

Shtojce 2.

Rregullën nr. 13 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve-KQZ që rregullojnë Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimet për Ngjarjet Politike mund ta gjeni në vegzën: http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/13_siywfrtqbc.PDF